NR. 24, SHKURT 2024 | Viti III

Revistë e përmuajshme (politike-diplomatike)

# ARGUMENTUM

news opinion analysis



## Sekretari Amerikan i Shtetit, Antony Blinken viziton për herë të parë Shqipërinë

**-5 vite ARGUMENTUM…**
Një Media Profesionale, e Paanshme dhe e Pavarur!

-Tirana mirëpret samitin për Ukrainën.

- Dy vite nga agresioni rus. Shqipëria në mbrojtje të integritetit territorial të Ukrainës!

ARGUMENTUM
news opinion analysis

**Të dashur lexues dhe ndjekës të Argumentum.al,**

**Argumentum.al** tashmë nga muaji prill 2022 vjen në versionin e një reviste të përmuajshme politike-diplomatike të cilën mund ta shfletoni online.
Ky botim mujor ofron një kombinim të qartë të lajmeve në vend, rajon dhe botë, si dhe opinioneve dhe analizave për ngjarjet e zhvilluara përgjatë një muaji.
Duke falënderuar secilin prej jush për vëmendjen dhe besimin ndaj medias tonë, ju premtojmë që do të vijojmë të sjellim për ju analizat objektive mbi zhvillimet kryesore në Vend, Rajon, Europë dhe në Botë.
**Argumentum.al** përpiqet të jetë burim autoritar i gazetarisë me analiza dhe komente mbi marrëdhëniet ndërkombëtare, politikën botërore dhe një gamë të gjerë çështjesh me rëndësi globale duke sjelle materiale ekskluzive. Kjo falë edhe kontributit të disa prej emrave të njohur të politikës dhe publicistikës shqiptare dhe bashkëpuntorëve të tjerë vendas dhe të huaj. Në të njëjtën kohë Argumentum.al është e hapur për komente e mendime të lexueseve të saj.
Lexoni falas mbi çështjet e brendshme dhe ndërkombëtare në revisten Argumentum.al në shqip dhe anglisht!

**"Argumentum", një proces intelektual ...**

**Marjana DODA**
**Kryeredaktore**

# Përmbajtja


**03 EDITORIAL**
- 5 vite ARGUMENTUM...Një Media Profesionale, e Paanshme dhe e Pavarur!

**05 POLITIKË**
- Sekretari Amerikan i Shtetit, Antony Blinken viziton Shqiperinë për herë të parë!
- Lajmi që solli Blinken: Së shpejti përurohet baza ajrore e NATO-s në Kuçovë!

**07 OP/ED**
- POPULIZMI E RRËNON EKONOMINË!
- 20 shkurti rënia e ideologjisë, por jo rrëzimi i mitit!

**11 JO VETEM LAJM**
- Speciale/ Dy vite nga agresioni rus në Ukrainë. Shqipëria në mbrojtje të integritetit territorial të Ukrainës!
- Manifestim në mbështetje të Ukrainës, Shkurov: Shqipëria, solidaritet dhe mbështetje për qytetarët tanë

**15 FOKUS**
- TIRANA MIRËPRET SAMITIN PËR UKRAINËN!

**17 REALPOLITIK**
- Retorika e politikanëve shqiptarë përballë sfidave gjeopolitike rajonale e globale

**18 BOTA**
- Vladimir Putin jep intervistën e parë që nga pushtimi i Ukrainës: Jemi gati të negociojmë për paqe!
- Vdes në burg Alexej Navalny, lideri opozitar rus dhe kundërshtari më i madh i Putinit

*ENGLISH EDITION*

**23 ENGLISH TOP NEWS**
- US secretary Blinken in Tirana, appreciates PM Edi Rama and alliance with Albania

**24 IN FOCUS**
- Ukraine-Southeast Europe Summit Declaration

**26 BALKAN OVERVIEW**
- Kurti and Vučić face off at the UN over dinar

**27 REALPOLITIK**
- Zelenski in Tirana! Summit for the sake of summit! Not like Nastradin's music! If you want peace, prepare for war! EBRD and Basso strips off our veil"!

**29 GLOBAL**
- OSCE leaders demand immediate end to Russia's war against Ukraine
- Putin says defeat in Ukraine 'impossible' in interview with US journalist Tucker Carlson

# 5 vite ARGUMENTUM...
# Një Media Profesionale, e Paanshme dhe e Pavarur!




**Të nderuar lexues dhe ndjekës të medias gjeopolitike, Argumentum.al.**
Më 15 shkurt 2019, u themelua media online ARGUMENTUM.al, e cila sot mbush 5 vjet që nga themelimi i saj. Një media që i dedikohet, ndër të tjera gjeopolitikës, e cila sjell më afër jush ngjarjet dhe zhvillimet gjepolitike globale.

Kjo media lindi nga dashuria  e madhe për gazetarinë, dhe dëshirën për ti ofruar lexuesit një media profesionale dhe të profilizuar. Në një kohë që në tregun tonë mediatik ofrohet "Gjithçka " dhe Asgjë " në të njëjtën kohë, Ne zgjodhëm të ndjekim rrugën më të gjatë dhe më të vështirë, rrugën e një media Profesionale, të Paanshme dhe të Pavarur.

Kjo është arritur padiskutim falë të gjithë kontributit intelektual të të gjithë bashkëpunëtorëve të Argumentum.al që nga dita e parë e themelimit të saj e deri më sot, nga Gazetarë, Analistë, dhe Miq të vyer të Argumentum.al. Falenderim dhe Mirënjohje për secilin prej jush!

Njëkohësisht në Jubileun e parë të ARGUMEN-

TUM, falënderojmë të gjithë ato personazhe, dhe institucione kombëtare e ndërkombëtare që kanë zgjedhur median tonë, për të përcjellë zërin e tyre te lexuesi shqiptarë. Janë dhjetra intervista ekskluzive nga Ambasadorë, Diplomatë, Analistë, Publicistë, nga vendi dhe rajoni si dhe nga njerëz të tjerë të shquar dhënë për Argumentum.al.

Një falenderim i përzemërt shkon për të gjithë Ju lexues dhe ndjekës të Argumentum.al, që keni qëndruar besnike dhe vijoni të besoni tek ne. Faleminderit!

Në 5-vitet e para të ARGUMENTUM në tregun mediatik, në sajë të profesionalizmit dhe të paanshmërisë, ka arritur të bëhet media partnere e disa organizateve të rëndësishme europiane në Ballkan, konkretisht, për vitin 2022-2023, Argumentum ishte Partner Mediatik për Shqipërinë me “Fondin Evropian për Ballkanin”.

Megjithatë, partneritetin më të rëndësishëm Argumentum.al e ka me ju lexues të dashur. Ju që dëshironi një media serioze dhe korrekte, një media informuese dhe analitike,

Të nderuar lexues të Argumentum.al,
Ju rikujtojmë se në “Argumentum”, si në variantin shqip (https://www.argumentum.al) ashtu edhe në anglisht (https://www.argumentum.al/englishHome/ gjeni Analiza, Opinione nga ekspertë dhe autorë të njohur, Intervista ekskluzive si dhe Këndvështrime të ngjarjeve që ndodhin në hapësirën tonë ndër-rajonale. Për të gjitha ngjarjet ndër-rajonale; ato mbajnë emrat e ekspertëve të shquar politikë, diplomatëve dhe publicistëve.

Gjithashtu, Argumentum.al nga prilli i vitit 2022 vjen në versionin e një reviste mujore politiko-diplomatike të cilën mund ta shfletoni online.( https://argumentum.al/revista/.

Duke u bërë kështu media e parë online që sjelle një revistë gjeopolitike. Ky publikim mujor ofron një kombinim të qartë të lajmeve lokale, rajonale dhe botërore, si dhe opinione dhe analiza mbi ngjarjet e muajit.

Ndërsa që nga Janari 2024, “Argumentum” vjen pranë jush tashmë edhe nëpërmjet kanalit të saj në YouTube @argumentumchannel
Në këtë kanal, Ju do të gjeni rubrikat ekskluzive nga ARGUMENTUM, si “Realpolitik”, “Jo Vetëm Lajm”, “Fokus”, “Retrospektive Diplomatike”, “Editorial”, etj.

Argumentum.al përpiqet të jetë një burim autoritar i gazetarisë me analiza dhe komente mbi marrëdhëniet ndërkombëtare, politikën botërore dhe një gamë të gjerë çështjesh me rëndësi globale duke sjellë materiale ekskluzive.

Kjo falë edhe kontributit të disa prej emrave të njohur të politikës dhe gazetarisë shqiptare dhe bashkëpunëtorëve të tjerë vendas e të huaj.

Duke falënderuar secilin prej jush për vëmendjen dhe besimin ndaj medias tonë, ju premtojmë që do të vijojmë të sjellim për ju analizat objektive mbi zhvillimet kryesore në Vend, Rajon, Europë dhe në Botë.




Kjo Media është për JU!

Faleminderit!

Marjana DODA

Kryeredaktore

# Sekretari Amerikan i Shtetit, Antony Blinken viziton Shqipërinë për herë të parë!

Sekretari amerikan i Shtetit Antony Blinken vizitoi Shqipërinë për parë të parë më 15 shkurt, e gjashta e një shefi të diplomacisë amerikane në Shqipëri që pas rrënies së rregjimit komunist.

Blinken u prit në një ceremoni zyrtare nga ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Igli Hasani, ambasadori shqiptar në SHBA, Ervin Bushati dhe zyrtarë të ambasadës amerikane në Tiranë.

Gjatë vizites 8 orëshe, ai është takuar me presidentin Bajram Begaj, kryeministrin Edi Rama, të rinj të mbështetur nga Amerika dhe krerët e institucioneve të drejtësisë.

Kryeministri Edi Rama u takua me Sekretarin amerikan të shtetit Blinken dhe delegacionin që e shoqëronte, në Sallën e Hartave, në Kryeministri.

Pas bashkëbisedimit me dobi të veçantë për forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve mes dy vendeve, u zhvillua ceremonia e nënshkrimit të dy Memorandumeve të Mirëkuptimit, përkatësisht:

– Memorandum Mirëkuptimi për Programin e Shkëmbimit Akademik Fulbright.

– Memorandum Mirëkuptimi për Kundërshtimin e Manipulimit të Informacionit të Shtetit të Huaj, të cilat u nënshkruan nga Sekretari Amerikan i Shtetit Antony Blinken dhe Ministri për Europën dhe Punët e Jashtme Igli Hasani.

Pas nënshkrimit, Kryeministri Edi Rama dhe Sekretari Amerikan i Shtetit dhanë një konferencë të përbashkët për shtyp.

Marrëdhëniet mes Shteteve të Bashkuara dhe Shqipërisë janë më të fuqishme se "kurrë më parë", ka thënë sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, të enjten gjatë vizitës së tij të parë zyrtare në Tiranë, të cilën kryeministri shqiptar Edi Rama e cilësoi si "ditë të shënuar" në historinë e Shqipërisë.

Duke folur në një konferencë për media me Ramën, Blinken e falënderoi Shqipërinë për rolin e saj në NATO, si dhe për mbështetjen e Ukrainës dhe dënimin e agresionit rus.

"Siç e dini, Shqipëria ka qenë nga dita e parë mbështetëse e fuqishme e Ukrainës. Ishte ndër vendet e para që i dërgoi municion Ukrainës, armë, municion dhe automjete rezistente ndaj minave. Tani është në top 10 vendet për kokë banori që e mbështet Ukrainën ", tha ai

Prej shkurtit 2022 kur nisi pushtimi rus i Ukrainës, Shqipëria - anëtare e NATO-s që nga viti 2009 - është rreshtuar me këtë aleancë ushtarake dhe me Bashkimin Evropian në mbështetjen e Ukrainës.

Ajo gjithashtu kanë përkrahur një rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së që dënon pushtimin rus të Ukrainës dhe ka ndërmarrë një iniciativë për dokumentimin dhe hetimin e krimeve të luftës në Ukrainë, përmes OKB-së.



"Përgjatë 15 vjetëve të saj në NATO Shqipëria ka dhënë kontribute domethënëse për aleancën tonë. Trupat shqiptare ndihmojnë për të ruajtur paqen në Kosovë, për të frenuar agresionin e Rusisë në krahun lindor të NATO. Muajin e ardhshëm do të përurojë bazën ajrore të NATO-s në Kuçovë. Ne jemi falënderues që Shqipëria po bën pjesën e saj dhe është e angazhuar për të mbajtur detyrimet e saj", tha Blinken.
Ai tha se SHBA-ja do të vazhdojë ta mbështetë Shqipërinë në arritjen e reformave në sistemin e drejtësisë, të cilat janë të rëndësishme për rrugën e saj drejt anëtarësimit në Bashkim Evropian.
"Reformat në drejtësi nuk kanë qenë të lehta, por po tregojnë rezultate të vërteta. Sot u takova me gjykatës dhe prokurorë të lartë që po ndihmojnë në përpjekjet për reforma. Zyrtarët e korruptuar po mbahen përgjegjës. Anëtarët e krimit të organizuar po shkojnë në burg dhe po i humbin asetet e tyre. Ky është proces i fuqishëm", tha Blinken.

# Lajmi që solli Blinken: Së shpejti përurohet baza ajrore e NATO-s në Kuçovë!

Baza ajrore e Kuçovës pritet të hapet muajin e ardhshëm, zbuloi sekretari amerikan i shtetit gjatë deklaratës për median pas takimit me kryeministrin Edi Rama në Sallën e Hartave, në Kryeministri.
Duket që baza ajrore ka qenë pjesë e bisedimeve dypalëshe
"Muajin e ardhshëm Shqipëria do të përurojë bazën ajrore të NATO-s në Kuçovë. Të 31 aleatët tanë që së shpejti do të bëhen 32 aleatë të NATO-s, do të sjellin përvoja të ndryshme, gjeografi të ndryshme, aftësi të ndryshme, kapacitete të ndryshme, por secili prej nesh ka të njëjtin angazhim në fakt të fortë, të hekurt, i cili është të ndihmojmë njëri-tjetrin dhe gjithashtu të sakrifikojmë, madje në vitin e fundit çdo aleat ka rritur përqindjen në ndihmë të mbrojtjes si 2% i PBB-së".
Blinken vlerësoi kryeministrin Rama si një partner të jashtëzakonshëm të SHBA-së dhe kontributin që Shqipëria ka dhënë për Ukrainën që nga ditët e para të agresionit rus si dhe misionet e NATO-s.
Por ndërsa baza ajrore e NATO-s në Kuçovë do të hapet, diskutimet për ndërtimin e një baze detare




të saj në Durrës, në Pashaliman për të cilën Shqipëria ka ofruar gatishmërinë, vijojnë.
"Tani për sa i takon bazës ajrore para së gjithash është e rëndësishme që të nënvizojmë disa gjëra; së pari: Tashmë kanë kaluar 15 vjet që kur Shqipëria është bërë aleate e NATO-s dhe fakti që do të përurohet, do të përurohet në fakt baza ajrore e Kuçovës, vetëm pak javë më vonë dhe kjo është një mënyrë e mrekullueshme për të nënvizuar dhe për të theksuar angazhimin që Shqipëria ka bërë ndaj NATO-s dhe gjithashtu në atë që NATO ka ndaj Shqipërisë dhe ky është një shembull tejet i fortë për partneritetin që ne gëzojmë me njëri-tjetrin. Ndërsa kur bëhet fjalë për bazën detare, kjo është diçka që ne e kemi diskutuar dhe do të vazhdojmë ta diskutojmë këtë përmes NATO-s dhe procesit që NATO ka përsa i përket vendosjes së aseteve të tjera të cilat janë të rëndësishme, të blera për aleancën dhe jam i sigurt që teksa diskutojmë NATO do të thotë më shumë"
Në total investimi kap një vlerë prej rreth 50 milionë euro. Kontributi i palës shqiptare shkon në rreth 10% të vlerës së përgjithshme të investimit në këtë bazë, e cila me investimin e NATO-s do të kthehet në një bazë taktike të dislokueshme.

# POPULIZMI E RRËNON EKONOMINË!

*Ekskluzivisht për ARGUMENTUM*

> Këtë dukuri e ka vërtetuar qartë një studim serioz i përfunduar javët e fundit nga Instituti i Ekonomisë Botërore i Kielit në Gjermani. Autorët e tij i janë referuar 120 viteve të fundit, duke analizuar 51 shembuj të ndikimit populist mbi produktin e brendshëm kombëtar, nga Hitleri, Musolini, e deri te Trumpi dhe Xhonson i Britanisë së Madhe.

NGA DR. JORGJI KOTE

Siç po nënvizohet në shumë analiza prestigjioze të kohëve të fundit, bashkë me ekstremizmin e djathtë, në shumicën dërmuese të vendeve të mëdha dhe ato demokratike, populizmi po bëhet një rrezik dhe kërcënim serioz për shtetin e të drejtës. Natyrisht këtu ai po përfiton nga gabimet dhe deficitet e mëdha demokratike në shumë vende perendimore, duke filluar nga SHBA-të, Franca, Gjermania, Italia, Britania e Madhe dhe të tjera, duke gërryer shkalë shkallë forcat politike tradicionale, të majta dhe të djathta. Tashmë forcat dhe liderët populistë i gjen në SHBA, ku spikat Trump, i cili po synon riardhjen në krye të Shtëpisë së Bardhë vitin e ardhshëm, në Britani Boris Xhonson, në Itali Meloni, në Francë Le Pen, e cila duket si kandidatja më e mundshme për të ardhur në krye të shtetit, në Finlandë, Suedi, Turqi dhe gjetkë.

Në Gjermani po përshkallëzon veprimtarinë e saj subversive "Alternativa për Gjermaninë" (AfD) e cila mbasi ka rritur ndeshëm praninë e saj në Bundestag dhe në parlamentet e landeve, po synon të fitojë në një nga tri shttet gjermane ku do të ketë zgjedhje të reja.



Mirëpo problemi është se populizmi nuk premton diçka të mirë dhe pozitive në jetën e përditshme e ca më pak në përparimimin demokratik. Kjo duke filluar nga ekonomia, bashkëpunmi tregtar, investimet e huaja, lufta kundër varfërisë, etj.

Këtë dukuri e ka vërtetuar qartë një studim serioz i përfunduar javët e fundit nga Instituti i Ekonomisë Botërore i Kielit në Gjermani. Autorët e tij i janë referuar 120 viteve të fundit, duke analizuar 51 shembuj të ndikimit populist mbi produktin e brendshëm kombëtar, nga Hitleri, Musolini, e deri te Trumpi dhe Xhonson i Britanisë së Madhe.

Sipas këtij studimi, 2 – 3 vjet mbas ardhjes në pushtet të populistëve, produkti i brendshëm bruto (GDP) bie në 2 – 3 për qind dhe më shumë. Ndërsa për një periudhë më të gjatë prej 10 -15 vitesh, ekonomia bie mbi 10 për qind. Sipas njerit prej autorëve të këij studimi, Dr. Christopf Trebesch, kjo ndodh për shkak të dekurajimit të madh që shkaktojnë partitë dhe liderët populistë në

rënimin ekonomik të një vendi. Shenjat e kësaj dukurie shqetësuese fillojnë nga rënia e treguesve në bursa, sepse çdo dobësim i demokracisë pasqyrohet menjëherë në to. Ndërkohë, tkurren investimet e huaja, mbasi populistët nuk janë tërheqës dhe joshës, madje i trembin ata dhe me ndryshimet e shpeshta ligjore në dëm të tyre.

Kjo u duk qartë gjatë 4 viteve të presidencës Trump  dhe sidomos gjatë dhe pas fushatës britanike për largimin nga BE-ja ( Brexit) Llogaritet se disa vite mbas tij, ekonomia britanike jo vetëm nuk shënoi rritjen e premtuar, por ajo ka rënë mbi 3 për qind, dhe nuk shihet ndonjë perspektivë përmirësimi as në të ardhmen. Po ashtu, tre vite më parë, populisti Salvini pësoi disfatë pîkërisht me ekonominë por jo vetëm, duke çuar vendin në zgjedhje të parakohshme. Ndryshe nga populistët, vendet ish lindore, mbas anëtarësimit në BE i kanë dyfishuar ritmet e rritjes së tyre ekonomike.

Të dhënat e këtij studimi janë të kuptueshme dhe të pritshme. Po të shohësh ideologjinë, sloganet dhe  veprimet praktike të populistëve, aty bië në sy mungesa totale e analizave  ekonomike, mospërpunimi i alternativave më të mira qeverisëse; populistët shquhen për gjuhën e rrugës, açik, troç, "mbarë e mprapsht", pa e vrarë mendjen për shtetin dhe për zgjidhje; ata ngrejnë probleme, por zgjidhjet ua lenë të tjerëve; nga ana tjetër, populistët duan vetëm suksese dhe aspekte pozitive, duke i përvetësuar vetë meritat

*Po të shohësh ideologjinë, sloganet dhe  veprimet praktike të populistëve, aty bië në sy mungesa totale e analizave  ekonomike, mospërpunimi i alternativave më të mira qeverisëse; populistët shquhen  për gjuhën e rrugës, açik, troç, "mbarë e mprapsht", pa e vrarë mendjen për shtetin dhe për zgjidhje; ata ngrejnë probleme, por zgjidhjet ua lenë të tjerëve; nga ana tjetër, populistët duan vetëm suksese dhe aspekte pozitive, duke i përvetësuar vetë meritat për to; ndërsa të metat, problemet, skandalet ua atribuojnë të tjerëve, medias, shoqërisë civile, "armiqve të brendshëm dhe atyre të jashtëm"; te këta të fundit tabela më e shpeshtë e goditjeve është padyshim Brukseli.*

për to; ndërsa të metat, problemet, skandalet ua atribuojnë të tjerëve, medias, shoqërisë civile, "armiqve të brendshëm dhe atyre të jashtëm"; te këta të fundit tabela më e shpeshtë e goditjeve është padyshim Brukseli. Populistët dinë mirë vetëm të kritikojnë, të denoncojnë, të demonizojnë dhe të nxijnë gjithçka, me qëllim që të marrin votat e nevojshme për të ardhur në pushtet. Mirëpo kur vijnë në pushtet, në vend të ofrojnë zgjidhje dhe alternativa, ata sajojnë dhe shpikin lloj lloj justifikimesh, duke përdorur si "gjethe fiku" luftrat, fatkeqësitë natyrore, veprimtarinë armiqësore, etj, etj.

Gjithsesi, rënia dhe rënimi ekonomik është vetëm një nga pasojat dhe të këqiat me të mëdha, por jo e vetmja. Probleme serioze ata krijojnë dhe në fusha të tjera, sidomos në atë të migrimit dhe gjeopolitike. Ja pse javët e fundit në Gjermani kanë shpërthyer protesta masive të papara kundër populistëve të AfD-së. Si rrjedhojë e kësaj trysnie masive nga poshtë, ka patur një gërryerje të madhe të AfD-së dhe rënie të saj në sondazhet e tanishme. Gjithsesi, rreziku populist, ashtu si dhe ai ekstremist i djathtë, pa përjashtuar atë të majtë mbetet një sfidë e madhe për demokracinë në secilin shtet të botës, përfshirë Ballkanin dhe vendin tonë. Zgjedhjet e reja për Parlamentin Europian në qershor,  presidencialet amerikane në nëntor, si dhe në Rusi, Indi, Britaninë e Madhe, Austri, Maqedoninë e Veriut, etj janë një shans i madh për t'i treguar vendin populistëve kudo. Nëse forcat e vërteta të moderuara demokratike do të dështojnë, kjo do të ketë pâsojë në shtilin e populistëve në Parlamentin Europiann, duke u bërë nxitje për rezutate më të larta dhe në zgjedhjet e ardhëshme në të gjitha vendet e tjera.

Le të shpresojmë se forcat e moderuara do të nxjerrin mësime nga pësimet, duke bërë korrigjimet e nevojshme në politikat e tyre, me qëllim që të mos i lenë asnjë shteg forcave populiste dhe ekstremiste. Mundësitë janë, le të punojmë fort!

# 20 shkurti rënia e ideologjisë, por jo rrëzimi i mitit!




NGA ALBAN DACI

> Shqipëria sot ndodhet në një situatë thuajse të ngjashme, sepse përballet e mitin e pazëvendësueshmërisë në politik dhe me faktin se tranzicioni tashmë pas 33 vitesh nuk mund të konsiderohet një fazë tranzitore, por ka krijuar një model hibrid të demokracisë duke u transformuar në një model konkret qeverisje, organizimi politik dhe social.

20 shkurti është padyshim një ndër datat më të rëndësishme që nga Lufta II Botërore, e cila kërkon një studim serioz dhe të thelluar dimensional si historik, politologjik, simbolikës dhe të lidershipit.

20 shkurti na mëson disa gjëra që shpesh nuk i marrim parasysh ose i anashkalojmë.

- 20 shkurti nuk ishte produkt ekskluziv i vullnetit të shqiptarëve për të rrëzuar Regjimin. Madje, ka disa pikëpamje në lidhje me këtë dhe ndoshta ajo më kryesorja është fakti se Regjimi ra vetë, sepse dështojë si model i organizimit ekonomik, politik apo shtetëror. Përballja mes ideologjisë kapitaliste dhe komuniste në gjithë Luftën e Ftohtë do të përfundonte me humbjes e njërit dhe fituesit e tjetrit. Pra, modeli komunist ose modelet e tjera të personalizuar në stalinist apo thuajse ai sui generis enverist shqiptarë dështuan, sepse nuk kishin çfarë t'i ofronin më shoqërisë. Komunizmi erdhi si pasojë e zhvillimit industrial, ndarjes së punës dhe evoluimit të shoqërisë që në fillim pati sukses, por sipas meje ishte e mbetej një formë tranzitore që nuk garantojë një përjetësi. Pra nëse bëjmë një pyetje thelbësore: A e mundën shqiptarët Komunizmin ose më saktë enver-

izmin? Modeli shqiptar ishte i identifikuar dhe personalizuar me diktatorin e Hoxha dhe shpesh vdekja fizike e liderit nënkupton edhe fundin e modelit të aplikuar prej ti, për sa kohë ky i fundit nuk e kishte bërë të trashëguar me model monarkie e po ashtu ai nuk kishte krijuar një shtresa të shëndoshë që mund të identifikohej me modelin shoqëror dhe organizimin politik. Gjithashtu, në vitet e fundit të jetës, Hoxha duke eliminuar thuajse të gjithë bashkëpunëtorit e tij ose të themi elitën që përbënte modelin e tij, ai ndihmojë në rënien e Regjimit e po ashtu e përshpejtojë atë. Përgjigja më e saktë është se shqiptarët nuk e mundën komunizmin si model shtetëror, por ai mundi vetveten.

- 20 shkurti nuk është rezultat ekskluziv shqiptar! Enverzimi i importuar si pasojë e revolucionit bolshevik në Moskë dhe më pas i stalinizmit ishte një model i importuar dhe po ashtu qëndrueshmëria e tij dhe jetëgjatësia e tij varej drejtpërdrejtë nga ngjarjet apo proceset ndërkombëtare. Rënia ose kriza e Bashkimit Sovjetik, revolucioni rumun dhe vrasja e Cauceskut, kriza e thellë ekonomike e Shqipëri, izolimi i saj ndërkombëtar, vdekja e Enverit e ndihmuan dhe e bën thuajse të natyrshme rënien e Regjimit dhe rrëzimin e bustit të Diktatorit. Pra, nëse nuk do të kishim këto faktor ndërkombëtar Shqipëri apo shqiptarët nuk do ta rrëzonin dot Regjimin.

- 20 shkurti na mëson diçka themelore, atë që herë pas here është analizuar shpesh edhe në mediume. Regjimet diktatoriale nuk rrëzohen vetëm me protesta masive të qytetarëve, por ky regjim si çdo regjim tjetër rrëzohet vetëm me protagonist që vijnë nga Brenda llojit. Jo rastësish protagonistët kryesore të viteve '90 që më vonë u bënë protagonistët kryesor të lidershipit në vitet në vazhdim ishin kryesisht intelektual të afirmuar dhe me privilegje që vinin nga Regjimi.

- 20 shkurti nuk e rrëzojë ideologjinë dhe po ashtu as nuk e forcojë ndarjen ideologjike. Pse e them ketë? Sepse, lëvizjet dhe protestat e Shqiptarëve nuk kishin në themel kërkesa ideologjike, por kërkon demokraci dhe liri. Në fakt, këto dy kërkesa janë edhe të majtës dhe të djathtës në një vendet demokratike. Ne nuk kishim eksperienca të shtetit të së drejtës dhe kjo na bëri që të majtën ose ideologjinë e saj ta lidhnim me diktaturën dhe totalitetin. Si pasojë e një mungesë eksperiencë në dallimet ideologjike bëri që PD të ishte e vetme parti në demokracitë liberale, të kishte një emër që i referohet të Majtës dhe të vetë identifikohej me të djathtën. Në fakt PD e Shqipërisë është vetmja në demokracitë perëndimore që identifikohet si e djathtë. Ky është shembulli më i mirë që lëvizjet studentore nuk kishin qëllime apo karakter ideologjik, por kërkon demokracinë dhe lirinë si dy forma bazë të shtetit të së drejtës për të cilët shqiptarët ishin privuar prej vitesh.

- 20 shkurti shënoi rënien e ideologjisë komuniste, por nuk rrëzojë mitin. Në fakt edhe pse data 20 shkurt është një protestë kundër mitit të Enver Hoxhës, arsyeja për të cilën shqiptarë e rrëzuan monumentin e tij, por në vitet në vazhdim deri në ditët e sotme nuk e rrëzuan personifikimin e unit dhe mitit, por ndërtuar të tjerë të ngjashëm prej të cilëve nuk po çlirohen dot as sot pas 33 vitesh.

- 20 shkurti është edhe memorie edhe ngjarje historike. Tashmë pas 33 vitesh kjo është një ngjarje dhe një memorie që dëshmon faktin se kur një popull kërkon përmbysje ai e bën, po ashtu në fakt historia është edhe leksion për të mësuar që disa fenomene të mos përsëriten. A nxorën shqiptarët mësime nga kjo ngjarje? Mendoj se jo! Shqipëria sot ndodhet në një situatë thuajse të ngjashme, sepse përballet e mitin e pazëvendësueshmërisë në politik dhe me faktin se tranzicioni tashmë pas 33 vitesh nuk mund të konsiderohet një fazë tranzitore, por ka krijuar një model hibrid të demokracisë duke u transformuar në një model konkret qeverisje, organizimi politik dhe social.

- Dështimi I modelit të tranzicionit dhe kriza për alternativa të reja, humbja e kujtesës ose mungesa e saj për brezat e rij ka bërë që të kthehet një nostalgji për Regjimin duke e konsideruar si formë më të mirë sesa ajo për të cilën u ngritën e shpresuan shqiptarët. Sot, shqiptarët kanë dy sfida, të rrëzojnë mitin që nuk e bënë me datë 20 shkurt dhe të krijojnë ose të besojnë në një alternativë të re që është më e mirë se tranzicioni dhe diktatura.

**SPECIALE** DY VITE NGA AGRESIONI RUS NË UKRAINË

# Shqipëria në mbrojtje të integritetit territorial të Ukrainës!



Më 24 shkurt bëhen dy vite nga agresioni ushtarak i Rusisë kundër Ukrainës! Dy vite më parë Rusia nisi pushtimin e saj në shkallë të plotë të Ukrainës, agresion i cili kushtoi të paktën 400 mijë viktima në të dy frontet.

Shqipëria ka treguar që ka qëndruar krah Ukrainës dhe ka dënuar agresionin rus në Ukrainë. Mesazhe solidariteti në këtë 2-vjeçar vijnë krerët më të lartë të politikës në Shqipëri duke treguar edhe një herë mbështetjen politiko-diplomatike dhe jo vetëm ndaj Ukrainës përballë agresionit rus.

Presidenti i Republikës, Bajram Begaj, përcolli sot një mesazh në 2-vjetorin e nisjes së agresionit rus në Ukrainë, luftë e cila vazhdon duke sjellë viktima dhe shkatërrime bashkë me rrezikun e përhapjes së konfliktit.

“Sot jemi dëshmitarë të qëndresës heroike të popullit ukrainas për liri, dinjitet dhe për mbrojtjen e vendit”, shprehet Presidenti Begaj i cili sjell në vëmendje pasojat e kësaj lufte.

Kreu i shtetit rikonfirmon qëndrimin e Shqipërisë krah Ukrainës dhe në mbrojtje të vlerave universale.

“Dy vjet nga agresioni i pa provokuar dhe i pa justifikuar ushtarak i Rusisë kundër Ukrainës. Sot jemi dëshmitarë të qëndresës heroike të popullit ukrainas për liri, dinjitet dhe për mbrojtjen e vendit. Ukraina sot është ndërgjegjja jonë. Vlerat tona të përbashkëta dhe liria jonë janë në rrezik. Do të jemi gjithmonë në krah të Ukrainës dhe popullit të saj, si dhe në mbrojtje të vlerave universale”, u shpreh Begaj.




**Kryeministri Rama: Lufta e zgjedhur e Rusisë në Ukrainë është e paligjshme, e padrejtë dhe e pajustifikuar.**

Ndërsa Kryeministri Edi Rama nëpërmjet një video-mesazhi i është drejtuar popullit ukrainas me fjalë mbështetëse në dyvjetorin e pushtimit të plotë rus të Ukrainës.

“Lufta e zgjedhur e Rusisë në

Ukrainë është e paligjshme, e padrejtë dhe e pajustifikuar. Të ndihmosh Ukrainën për të mbrojtur veten është dhe duhet të mbetet. Angazhimi ynë kolektiv si një investim vendimtar për një botë të bazuar në të drejta, jo në fuqi, për një të ardhme të bazuar në bashkëpunim , jo agresioni, për një botë të bazuar në liri, jo në imponim. Duke bërë këtë luftë të bazuar në hartat e epokës së gurit, Vladimir Putin po pretendon të drejtën e Rusisë për të jetuar në të kaluarën. Përmes reagimit tonë të vendosur ndaj agresionit të Rusisë, ne pohojmë të drejtën tonë të jetojmë të lirë dhe të punojmë të gjithë së bashku drejt së ardhmes në të cilën besojmë"., theksoi ai ne kete mesazh per popullin ukrainas.




**Ministri për Europën dhe Punët e Jashtme, Igli Hasani: Jam krenar për rolin që Shqipëria ka luajtur në mbështetje të Ukrainës**

Ministri për Europën dhe Punët e Jashtme, Igli Hasani ka theksuar sot mbështetjen e vazhdueshme të Shqipërisë ndaj Ukrainës. Në dy vjetorin e fillimit të agresionit rus në Ukrainë, Hasani shprehet se "pa provokim, pa justifikim, Ushtria Ruse nisi një pushtim kundër një kombi sovran dhe të pavarur në Evropë, diçka që kontinenti ynë nuk e kishte parë që nga Lufta e Dytë Botërore".

Ministri shton se "prej dy vitesh, ne kemi qenë dëshmitarë të tmerreve të këtij pushtimi: shkatërrim, plaçkitje, përdhunime, vrasje të civilëve të pafajshëm dhe rrëmbime të mijëra fëmijëve ukrainas. Mariupol dhe Bucha mbahen mend për barbarinë e shfaqur nga ushtria ruse kundër kombit të lirë dhe të pavarur ukrainas".

Sipas tij, rezistenca e heroike e popullit ukrainas ka fituar admirimin e mbarë botës dhe ka mobilizuar solidaritet dhe mbështetje të pashoqe.

"Jam krenar për rolin që Shqipëria ka luajtur në mbështetje të Ukrainës, përkrah aleatëve dhe partnerëve tanë. Jam, veçanërisht, krenar për rolin që Shqipëria ka luajtur në Këshillin e Sigurimit të OKB-së për të fituar mbështetje diplomatike për Ukrainën dhe për të izoluar dhe dënuar Rusinë në luftën e saj të paligjshme. Ne kemi bërë të pamundurën për të mbështetur Ukrainën, sepse besojmë se Ukraina dhe populli i saj meritojnë të gjithë solidaritetin dhe mbështetjen që mund të marrin në luftën e tyre të drejtë", thekson kryediplomati shqiptar.

Ministri shton më tej se "ne kemi bërë maksimumin për të mbështetur Ukrainën dhe popullin e saj, edhe sepse kuptojmë se lufta e tyre është një luftë për sigurinë e Evropës dhe sistemin ndërkombëtar të bazuar në rregulla. Çdo gjë tjetër, do të inkurajonte çdo diktator dhe komb mashtrues në botë që të ndjekë rrugën e Vladimir Putin, duke e zvogëluar kështu ligjin ndërkombëtar në ligjin e xhunglës".

Hasani vë në dukje se "për ne, në Ballkanin Perëndimor, lufta në Ukrainë ka ringjallur kujtime dhe emocione të dhimbshme nga vitet 1990, kur rajoni ynë ishte shtëpia e luftës së fundit në Evropë. Por, lufta në Ukrainë ka ndikuar seriozisht edhe në sigurinë dhe stabilitetin e rajonit tonë".

Gjithashtu, ministri i Jashtëm sjell në vëmendje Samitin Ukrainë – Ballkani Perëndimor që mbahet më 28 shkurt, në Tiranë.

"Ky Samiti do të ofrojë një mundësi për liderët nga Ballkani Perëndimor dhe Evropa Juglindore për të diskutuar, se si ne mund të punojmë së bashku dhe si mund të ofrojmë të gjithë mbështetjen që mundemi për Ukrainën, të vetëdijshëm se duke ndihmuar Ukrainën ne po kontribuojmë gjithashtu në sigurinë dhe stabilitetin e rajonin tonë dhe Evropës", deklaron ministri Hasani.

Gjithashtu Ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi u shpreh sot se, mbështetja për Ukrainën kundër agresionit rus është siguri për Evropën dhe gjithë botën.

Në një reagim me rastin e dy vjetorit të fillimit të agresionit rus në Ukrainë, Peleshi theksoi se, "pas dy vitesh luftë, populli i Ukrainës dhe Forcat e saj të Armatosura vazhdojnë të qëndrojnë të fortë!".

"Mbështetja për Ukrainën kundër

agresionit Rus është siguri për Evropën dhe gjithë botën. Shqipëria do të vijojë pa kushte të jetë përkrah aleatëve dhe partnerëve në ndihmë të popullit dhe qeverisë ukrainase", nënvizoi Peleshi.
Ministri i Mbrojtjes u shpreh "vullnetplotë për të bërë gjithçka mundemi, që Ukraina të triumfojë në luftën e saj për liri".
Edhe Kryetari i grupit parlamentar të Partisë Demokratike, Gazment Bardhi, ka reaguar sot në 2-vjetorin e fillimit të luftës në Ukrainë, ai theksoi se "është dita që të gjithë të jemi bashkë në një përgjigje ndaj antivlerave që vënë në rrezik sigurinë kolektive".
"Dy vite më parë Rusia nisi pushtimin në shkallë të gjerë të një vendi të lirë dhe demokratik siç është Ukraina. Kjo tregon se paqja dhe demokracia mund të vihen nën sulm nga autokratë edhe në shekullin e XXI", u shpreh Bardhi, në një reagim në rrjetet sociale. Ndërsa vlerësoi qëndresën heroike të qytetarëve të Ukrainës, Bardhi u solidarizua me çdo viktimë të sulmeve barbare ruse.

# Manifestim në mbështetje të Ukrainës, Shkurov: Shqipëria, solidaritet dhe mbështetje për qytetarët tanë

Në Tiranë u mbajt sot një manifestim në solidaritet me Ukrainën 2 vite nga agresioni rus.
Ambasadori i Ukrainës në Shqipëri, Volodymyr Shkurov në fjalën e tij në aktivitetin e organizuar në sheshin përpara Bashkisë së Tiranës shprehu falënderime te tij për mbështetjen që Shqipëria i ka dhënë Ukrainës.
"Ju falënderoj për mbështetjen dhe solidaritetin e treguar. Ne jemi sot këtu për të dënuar agresionin rus kundër Ukrainës", tha ai.
"Asnjëherë nuk do ta harrojmë mëngjesin e 24 shkurtit 2022. Asnjëri prej njerëzve nuk mund ta besonte se Rusia mund të sulmonte, por ajo bëri pikërisht një akt agresioni. Këto 2 vite na kanë treguar se kush jemi dhe kush janë miqtë tanë", theksoi Shkurov
Shkurov uroi edhe ukrainasit që jetojnë në Shqipëri dhe falenderoi qeverinë shqiptare për ndihmën dhe mbështetjen.
"Jam mirënjohës për qeverinë shqiptare që kanë zgjatur pikërisht rezidencën e tyre dhe mbrojtjen për këta qytetarë që ishin të detyruar të linin atdheun e tyre".




"Falënderoj partnerët tanë të BE-së, NATO-s, Britanisë së Madhe, Gjermaninë, Francën, Spanjën, Italinë, Sllovakinë dhe shumë vende të tjera që kanë dhënë ndihmën e tyre të çmuar".
Shkurov gjithashtu falënderoi Presidentin e Republikës, Bajram Begaj, kryeministrin Edi Rama dhe Kryetaren e Kuvendit, Lindita Nikolla për solidaritetin që kanë treguar me popullin e Ukrainës.
"Veçanërisht për këto 2 vite mbështetje që kanë treguar gjithashtu edhe përsa i përket drejtimit që Shqipëria ka pasur në Këshillin e Sigurimit dhe për ndihmën financiare që qeveria shqiptare ka dhënë




për Ukrainën", tha ambasadori ukrainas.
Gjithashtu, Shkurov falënderoi edhe popullin shqiptar për ndihmën e madhe që kanë dhënë për popullin ukrainas.
Shkurov gjithashtu falënderoi bashkinë e Tiranës dhe kryebashkiakun Erion Veliaj për ndihmën e vazhdueshme.
Ai falënderoi edhe anëtarët e qeverisë dhe të partive partive politike shqiptare dhe ambasadorët e të gjitha vendeve që ishin të pranishëm, për solidaritetin e treguar ndaj popullit të Ukrainës.
Shqiperia qe ne krye te heres ka qene dhe vijon te jete ne krah te Ukrianes. Gjatë mandatit dyvjeçar në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, Shqipëria luajti një rol aktiv në paqen dhe sigurinë ndërkombëtare, si një prej vendeve që ka mbështetur Ukrainën.
Shqipëria ishte krah Shteteve të bashkuara të Amerikës si bashkëpenëmbajtëse e çështjes së Ukrainës në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.
Gjithashtu me iniciativë të kryeministrit të Shqipërisë, Z.Edi Rama, më 28 Shkurt, Tirana do të jetë mikpritëse e një samiti për Ukrainën, ku padyshim fokusi do të vendoset tek lufta dhe mbështetja ndaj Ukrainës. Më 28 shkurt në Tiranë merr pjesë presidenti ukrainas, Volodymyr Zelensky, në vizitën e tij të parë në Shqipëri.
Kujtojmë se Presidenti i Rusisë, Vladimir Putin, urdhëroi një "operacion ushtarak" në Ukrainë, në orën 5:55 të mëngjesit të 24 shkurtit 2022. Disa minuta më vonë pasuan granatimet e para. Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, shpalli gjendje lufte në vend.
Dy vjet më vonë, numri i viktimave nga lufta e Rusisë kundër Ukrainës shkon në dhjetëra mijëra, ndërkohë që shumë jetë të tjera janë çrrënjosur dhe qytete të tëra janë rrënuar. Dëmet materiale të shkaktuara nga lufta, të cilën Moska e filloi më 24 shkurt 2022 si një "operacion special ushtarak", vlerësohet në qindra miliarda dollarë.
Sipas një raporti të fundit nga Komiteti Ndërkombëtar i Shpëtimit (IRC), rreth 14.6 milionë ukrainas vlerësohet të kenë nevojë për ndihmë humanitare që nga ky vit, duke përfshirë 3.7 milionë të zhvendosur brenda vendit.
Që nga 24 shkurt 2022, lufta ka marrë jetën e të paktën 10,582 civilëve, duke përfshirë 5,017 burra, 3,093 gra dhe 587 fëmijë, sipas shifrave të fundit të OKB-së të publikuara këtë javë. Numri i të plagosurve është të paktën 19,875, duke përfshirë 6,524 burra, 4,546 gra dhe 1,298 fëmijë, njoftoi Zyra e Komisionerit të Lartë të OKB-së për të Drejtat e Njeriut.
Ndërsa Lufta Rusi-Ukrainë do të hyjë në vitin e saj të tretë këtë të shtunë, pasigurite jane edhe me te medha. Me furnizimet me armatime në Ukrianë dhe me stërvitjen më të madhe të NATO-s në sfond, lind pyetja; A po shkohet drejt një lufte të pafund dhe më të gjerë?

# TIRANA MIRËPRET SAMITIN PËR UKRAINËN!

## *Deklarata e Samitit Ukrainë-Evropa Juglindore në Tiranë: Agresioni i Rusisë, kërcënimi më i madh për sigurinë evropiane dhe paqes ndërkombëtare.*




Kryeministri Edi Rama dhe Presidenti i Ukrainës Volodymyr Zelensky, mikpritën së bashku, liderët pjesëmarrës në Samitin "Ukrainë-Europa Juglindore", i cili u zhvillua në Pallatin e Kongreseve, në Tiranë më 28 shkurt.

Ky takim me rëndësi të posaçme mbledh në një tryezë diskutimi liderët: Borjana Krišto, Kryetare e Këshillit të Ministrave të Bosnje dhe Herzegovinës; Maia Sandu, Presidente e Moldavisë; Vjosa Osmani, Presidente e Kosovës; Stevo Pendarovski, President i Maqedonisë së Veriut; Aleksandar Vučić, President i Serbisë; Andrej Plenković, Kryeministër i Kroacisë dhe Jakov Milatović, President i Malit të Zi – për të dëshmuar edhe njëherë vlerat e përbashkëta të vendeve në mbështetjen e pakushtëzuar ndaj Ukrainës

Liderët e vendeve të Europës Juglindore kanë lëshuar një deklaratë të përbashkët pas samitit të mbajtur në Tiranë për Ukrainën. Në deklaratën e përbashkët theksohet se agresioni ushtarak i Rusisë përballë Ukrainës mbetet kërcënimi më i madh për sigurinë evropiane dhe paqen ndërkombëtare.

Deklarata e plotë e liderëve të Europës Juglindore:

Ne, Presidentja Vjosa Osmani, Presidentja Maia Sandu, Presidenti Jakov Milatović, Presidenti Stevo Pendarovski, Presidenti Aleksandar Vučić, Presidenti Volodymyr Zelenskyy, Kryeministri Edi Rama, Kryetarja e Këshillit të Ministrave Borjana Krišto, Kryeministri Nikolay Denkov, Kryeministri Andrej Plenković, Kryeministri Ion-Marcel Ciolacu, u takuam në Tiranë më 28 shkurt 2024 dhe shpallëm deklaratën e mëposhtme:

**1.** Agresioni i paprovokuar ushtarak i Rusisë kundër Ukrainës mbetet kërcënimi më i madh ndaj sigurinë evropiane dhe paqes ndërkombëtare. Ky akt agresioni është i papranueshëm; është një shkelje flagrante e së drejtës ndërkombëtare, përfshirë Kartën e OKB-së, dhe një krim kundër popullit ukrainas.

**2.** Ne përsëritëm mbështetjen tonë të palëkundur për pavarësinë, sovranitetin dhe integritetin territorial të Ukrainës brenda kufijve të saj të njohur ndërkombëtarisht që nga viti 1991 dhe mbetemi të përkushtuar për t'i ofruar Ukrainës mbështetjen e nevojshme për të fituar kundër luftës së agresionit rus, për aq kohë sa duhet për t'u arritur një paqe gjithëpërfshirëse, e drejtë dhe e qëndrueshme në përputhje me Kartën e OKB-së dhe në bazë të Formulës së Paqes të Ukrainës.

**3.** Ne i bëjmë thirrje të gjithë komunitetit ndërkombëtar që të rrisë fuqishëm mbështetjen për

Ukrainën në luftën e saj aktuale për liri, pavarësi dhe integritet territorial.

**4.** Ne dënojmë me forcë synimet e Federatës Ruse për mbajtjen e zgjedhjeve presidenciale në territoret përkohësisht të pushtuara të Ukrainës, gjë që përfaqëson shkelje të hapur të së drejtës ndërkombëtare. Theksojmë natyrën e paligjshme të zgjedhjeve të ardhshme në Republikën Autonome të Krimesë dhe qytetin e Sevastopolit dhe në territoret e pushtuara nga Rusia të rajoneve Donetsk, Luhansk, Zaporizhya dhe Kherson të Ukrainës.

**5.** Gjatë diskutimeve të sotme në Tiranë, ne rikonfirmuam solidaritetin tonë me Ukrainën dhe popullin e saj në mbrojtjen e tyre heroike të lirisë së tyre dhe vlerave tona të përbashkëta dhe shprehëm gatishmërinë tonë për të marrë pjesë në zbatimin e Formulës së Paqes të Presidentit të Ukrainës Volodymyr Zelenskyy, e cila është në përputhje me Qëllimet dhe Parimet e Kartës së OKB-së, dhe të marrë pjesë në Samitin përurues të Paqes duke siguruar pjesëmarrjen më të gjerë të mundshme ndërkombëtare në këtë proces.

**6.** Ne jemi të bindur se lufta në shkallë të plotë e agresionit të Rusisë kundër Ukrainës ka treguar nevojën kritike dhe rëndësinë thelbësore të një Evrope të bashkuar dhe të fortë, e aftë për t'u përballur me sfidat globale për paqen dhe prosperitetin e popujve tanë. Theksuam se na bashkojnë vlerat e përbashkëta evropiane dhe vizioni i zhvillimit të tyre të mëtejshëm brenda një Evrope të bashkuar.

**7.** Ne konfirmuam vendosmërinë tonë për të intensifikuar përpjekjet e përbashkëta për të siguruar përparim të mëtejshëm dhe mbështetje të ndërsjellë drejt anëtarësimit të rajonit të Ballkanit Perëndimor, Ukrainës, Republikës së Moldavisë dhe Gjeorgjisë në Bashkimin Evropian.

*Sot në Tiranë, ne rikonfirmuam solidaritetin dhe mbështetjen tonë për Ukrainën, shprehëm angazhimin tonë për të marrë pjesë në rimëkëmbjen dhe rindërtimin e Ukrainës pas luftës, në mënyrë që t'i mundësojmë popullit ukrainas të rindërtojë vendin e tij, duke angazhuar të gjithë partnerët përkatës, përfshirë kompanitë private dhe ndërkombëtare, institucionet financiare, me synimin për të siguruar mbështetjen financiare, investimet dhe njohuritë e nevojshme për të siguruar një të ardhme të begatë për Ukrainën.*

**8.** Ne mbështesim plotësisht të drejtën e Ukrainës për të zgjedhur masat e veta të sigurisë. Aleatët e NATO-s dhe vendet aspirante vlerësojnë hapat e ndërmarrë drejt anëtarësimit të saj të ardhshëm në NATO dhe mbështesin Ukrainën që të bëhet anëtare e Aleancës sapo ta lejojnë kushtet e sigurisë.

**9.** Ne nënvizuam angazhimin tonë të vendosur për të sjellë para drejtësisë ata individë përgjegjës për krimin e agresionit, krimet kundër njerëzimit dhe krimet e tjera mizore sipas ligjit ndërkombëtar, të kryera në lidhje me luftën e agresionit të Rusisë kundër Ukrainës, përmes hetimeve dhe ndjekjeve të duhura, të drejta dhe të pavarura në nivel kombëtar ose ndërkombëtar, përfshirë punën e Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm të Ukrainës dhe Gjykatës Ndërkombëtare Penale për të siguruar që pretendimet për krime lufte dhe krime të tjera ndërkombëtare të hetohen plotësisht dhe në mënyrë të drejtë nga mekanizma të pavarur, efektivë dhe të fuqishëm ligjorë.

**10.** Ne ramë dakord të bashkëpunojmë dhe të përqendrojmë përpjekjet tona për kthimin e fëmijëve ukrainas, të dëbuar dhe të zhvendosur me forcë në mënyrë të paligjshme.

**11.** Ne zotohemi të rrisim përpjekjet tona bashkëpunuese për të luftuar dezinformimin, përfshirë narrativat e rreme rreth luftës, dhe të mbetemi të përkushtuar në përballimin e luftës hibride dhe sfidave të sigurisë kibernetike, duke kontribuar në stabilitetin dhe sigurinë e komunitetit ndërkombëtar.

**12.** Sot në Tiranë, ne rikonfirmuam solidaritetin dhe mbështetjen tonë për Ukrainën, shprehëm angazhimin tonë për të marrë pjesë në rimëkëmbjen dhe rindërtimin e Ukrainës pas luftës, në mënyrë që t'i mundësojmë popullit ukrainas të rindërtojë vendin e tij, duke angazhuar të gjithë partnerët përkatës, përfshirë kompanitë private dhe ndërkombëtare, institucionet financiare, me synimin për të siguruar mbështetjen financiare, investimet dhe njohuritë e nevojshme për të siguruar një të ardhme të begatë për Ukrainën. Ne nënvizojmë rëndësinë e çminimit në kontekstin më të gjerë të rimëkëmbjes së Ukrainës, si hapi fillestar i rëndësishëm drejt kthimit të sigurt të njerëzve dhe rifillimit të aktivitetit ekonomik dhe bujqësor.

Ne, miqtë e Ukrainës, konfirmojmë besimin tonë të fortë se vetëm duke u bashkuar do të jemi në gjendje të rivendosim paqen, stabilitetin dhe prosperitetin e drejtë në kontinentin evropian.

# Retorika e politikanëve shqiptarë përballë sfidave gjeopolitike rajonale e globale

Javët e fundit është theksuar dhe më tej dukuria e çuditshme e politikës sonë, kur si partia në pushtet por dhe një pjesë e PD-së zyrtare, mbasi nuk po i japin dot drejtim dhe zgjidhje sfidave dhe krizave të tyre të brendshme, po mundohen të luajnë si aktorë madhorë në skenën ndërkombëtare. Edhe pse pa kapacitete dhe besueshmërinë e duhur për të zgjidhur probleme shumë më të thjeshta brenda vendit, ata pretendojnë t'u japin zgjidhje problemeve dhe krizave më serioze të botës, madje" me një të rënë të shkopit.

Kështu, Kryeministri Rama mbas propozimeve për Kosovën nga ku nuk po ia dalin dot SHBA dhe BE-ja, ka dalë me gatishmërinë për të zgjidhur krizën në Lindjen e Mesme! Kjo bëhet qesharake kur mendon se ajo krizë e ndërlikuar që vijon për dekada është një sfide gjeopolitike edhe për fuqitë e mëdha perendimore! Kjo tregon se lidershipi ynë nuk ia ka idenë Realpolitikës! Ose mendon të faktorizohet thjesht dhe vetëm duke hedhur në treg ide dhe propozime gjeopolitike si retorikë propagandistike. Mirëpo, sado të mira e të dobishme të jenë këto ide dhe propozime, mjafton kur mësohet se vijnë nga vendi ynë pa peshë reale gjeopolitike dhe kancelaritë perendimoree t'i thonë me gjuhë të butë diplomatike " JO" ose të argëtohen me to si shaka dhe batuta politike të rradhës.

Tani së fundi, Kryeministri Rama në vend të projekteve ekonomike për rajonin njoftoi nga Shkupi se do të mbledhë në Tiranë një Samit për Ukrainën!!!! A thua se nuk ka vende të tjera shumë më të mëdha se ne për të tilla ngjarje?!

Nuk ngelet prapa as Lulzim Basha, i cili javën e kaluar në Strasburg, në Asamblenë Parlamentare të KiE-së propozoi sekuestrimin e depozitave bankare jashtë vendit të Rusisë prej 300 Miliard Euro!

Pra në vend të merrej me fatin e propozimit tonë të tetorit të vitit 2022 lidhur me Rezolutën e vitit 2010 që akuzon ish liderët e UÇK-së për trafikim të qenieve njerëzore! Basha, ndermerr hapa gjigant per kapacitetin e tij, aq me teper kur dihet se fati i depozitave bankare ruse është në dorë të SHBA-ve dhe BE-së!

Ndërkohë, Fatmir Mediu shpalli se në bashkëpunim me senatorë amerikanë organizuan një seancë në








Capitol Hill lidhur me mbështetjen ndaj Ukrainës! Ndonëse pengesa për këto ndihma vjen nga po republikanët, aleatët e Mediut! Ky i fudnit do të bënte shumë më mirë të kërkonte ndihmën e kongresmeneve amerikanë për të vendosur më parë rregull në shtëpinë e vet politike në Tiranë!

E pra, të gjitha këto veprime ngjajnë "si dy pika uji" me propagandën e kohës së komunizmit, madje po ia kalojnë asaj. Rezultati përfundimtar është se ato janë ca si shumë për mundësitë tona dhe shumë shumë pak për përfituesit.

Sikundër e kemi nënvizuar dhe më parë, është më mirë të përqëndrohemi në punën nga brenda e pastaj të dalim jashtë. Siç thoshte ish Kryeministri emblematik britanik, William E. Gladstone, suksesi i politikës së jashtme fillon nga brenda". Ndaj mund të themi se të tilla retorika për zgjidhje gjeopolitike mund të jenë marketing publik për të mbuluar hallet dhe telashet brenda vendit, për të shpërqëndruar vëmendjen nga aferat dhe skandalet e shumta, por asgjë më shumë.

# Vladimir Putin jep intervistën e parë që nga pushtimi i Ukrainës: Jemi gati të negociojmë për paqe!



Moska nuk ka refuzuar kurrë të zhvillojë bise-dime për Ukrainën dhe ka besim se konflikti herët a vonë do të përfundojë në paqe dhe marrëdhëniet midis popujve të dy vendeve do të rivendosen. Ne kurrë nuk kemi refuzuar negociatat me të vërtetë. Ne dëgjojmë gjatë gjithë kohës, a është gati Rusia? Po. Ne nuk kemi refuzuar. Ishin ata që e refuzuan publikisht. Epo, le ta anulojë dekretin e tij [për të mos negociuar me Rusinë] dhe le të hyjë në negociata, tha presidenti rus Vladimir Putin në një intervistë me Tucker Carlson të botuar në faqen TCN , platformë personale e gazetarit amerikan.

Intervista është shoqëruar me kritika të forta para dhe pas saj, duke e quajtur propagandë. Kjo është intervista e parë e Putinit me një figurë të mediave perëndimore prej se Rusia e nisi pushtimin e Ukrainës në fillim të vitit 2022.

**Argumentum.al** sjell disa nga pikat kryesore nga intervista e presidentit rus.

**Lidhur me Ukrainën**

Rusia nuk ka refuzuar kurrë të angazhohet në dialog për Ukrainën, por pasi bisedimet e Stambollit u pezulluan në mars 2022, Moska nuk ka ndërmend të ndërmarrë hapin e parë. “Pse duhet të shqetësojmë veten dhe të korrigjojmë gabimet e dikujt tjetër?”

Duhet të diskutohen kushtet për zgjidhjen e çështjes, duke përfshirë mundësinë e mbajtjes së situatës aty ku është tani. “Është një temë e negociatave që askush nuk është i gatshëm të zhvillojë ose, për ta thënë më saktë, ata janë të gatshëm, por nuk dinë ta bëjnë këtë. Unë e di që ata duan. Nuk është vetëm unë e shoh këtë, por unë e di që ata e duan atë, por ata po përpiqen të kuptojnë se si ta bëjnë atë.”

Ukraina është një shtet artificial në një farë kuptimi, “i formësuar me vullnetin e Stalinit” veçanërisht të tokave hungareze, polake dhe rumune. Putin tha se ai kurrë nuk kishte diskutuar një kthim të mundshëm të tokave hungareze, të cilat i ishin dorëzuar Ukrainës nën Stalinin, me kryeministrin e Hungarisë Viktor Orban. Sa i përket rajonit të Detit të Zi, ai “nuk kishte asnjë lidhje historike me Ukrainën”.

**Paqe me Ukrainën**

Putin tha se do të ishte i përgatitur për të negociuar një paqe me Volodymyr Zelenskyy, por shtoi se Rusia nuk i kishte arritur ende qëllimet e saj në vend, duke përfshirë “denazifikimin”. Ai tha: “Ne kurrë nuk kemi refuzuar negociatat me të vërtetë. Ne dëgjojmë gjatë gjithë kohës, a është gati Rusia? Po. Ne nuk kemi refuzuar. Ishin ata që e refuzuan publikisht. Epo, le ta anulojë dekretin e tij [për të mos negociuar me Rusinë] dhe le të hyjë në negociata. Ne nuk kemi refuzuar kurrë.”

**Për marrëdhëniet e ardhshme me ukrainasit**

Perëndimi gabon kur mendon se “populli rus është ndarë nga armiqësitë përgjithmonë”: “Herët a vonë do të rezultojë në një marrëveshje”. “Kjo ndoshta tingëllon e çuditshme duke pasur parasysh situatën aktuale, por gjithsesi marrëdhëniet mes dy popujve do të rindërtohen.

Do të duhet shumë kohë, por ato do të shërohen."

## Për "kërcënimin rus"

Akuzat për "kërcënimin rus" kanë për qëllim frikësimin e njerëzve të thjeshtë: "Ne nuk kemi asnjë interes në Poloni, Letoni apo askund tjetër. <…> Është thjesht një kërcënim". Putin këmbënguli se ai nuk kërkon të zgjerojë luftën në vendet fqinje si Polonia dhe Letonia. Putin përsëriti pretendimin e tij se pushtimi i Ukrainës ishte i nevojshëm për të ndaluar vendin nga kërcënimi i Rusisë duke iu bashkuar NATO-s, mohoi se ai kishte ambicie territoriale në të gjithë Evropën dhe këmbënguli se do të dërgonte trupa në vendet fqinje vetëm nëse sulmohej fillimisht. "Është absolutisht jashtë diskutimit. Thjesht nuk duhet të jesh asnjë lloj analisti, është kundër sensit të shëndoshë të përfshihesh në një lloj lufte globale… Dhe një luftë globale do ta sjellë të gjithë njerëzimin në prag të shkatërrimit. Është e qartë."

## Putin thotë se SHBA duhet të ndalojë furnizimin me armë

Udhëheqësi rus tha se qeveria e tij ishte në kontakt me Shtetet e Bashkuara dhe se një zgjidhje paqësore e luftës do të ishte e mundur vetëm nëse Uashingtoni ndalonte furnizimin me armë për Ukrainën. "Unë do t'ju tregoj se çfarë po themi për këtë çështje dhe çfarë po i përcjellim udhëheqjes amerikane. Nëse vërtet dëshironi të ndaloni së luftuari, duhet të ndaloni furnizimin me armë. Do të përfundojë brenda disa javësh, kaq, dhe më pas mund të biem dakord për disa kushte. Para se ta bëni këtë, ndaloni."

## Shpërthimet e gazsjellësit Nord Stream

Rusia nuk ka paraqitur provat që ka në lidhje me shpërthimet e gazsjellësit Nord Stream sepse "në luftën e propagandës është shumë e vështirë të mposhtni Shtetet e Bashkuara, sepse Shtetet e Bashkuara kontrollojnë të gjitha mediat e botës dhe shumë media evropiane". "Kështu që është e mundur të përfshihemi në këtë punë, por kjo është një kosto e padurueshme, si të thuash. <…> Është e qartë për të gjithë botën se çfarë ka ndodhur".

## Për bashkëpunimin me Kinën

Pretendimet se bashkëpunimi me Kinën është i rrezikshëm për Rusinë, nuk janë gjë tjetër veçse tregime boogeyman. Evropa ruan bashkëpunim edhe më të ngushtë me Kinën. "Pyesni evropianët, a kanë frikë?"

## Për Rusinë në NATO

Moska hetoi mundësinë e anëtarësimit në NATO dhe ftoi Uashingtonin që të ndërtonin së bashku një sistem të përbashkët të mbrojtjes raketore. Presidentët amerikanë i mbështetën iniciativat, por administratat e tyre i refuzuan ato. "Dhe pastaj ata thjesht na thanë të humbisnim. <…> Ne krijuam sisteme hipersonike me rreze ndërkontinentale dhe vazhdojmë t'i zhvillojmë ato."

Uashingtoni vazhdoi të ushtronte presion mbi Moskën veçanërisht sepse kishte shumë ekspertë për konfrontimin me Bashkimin Sovjetik në SHBA. "Është e nevojshme të hiqet qafe kjo. Duhet të ketë forca të reja, të freskëta, njerëz që shikojnë në të ardhmen dhe kuptojnë se çfarë po ndodh në botë."

## Marrëdhëniet me presidentet e SHBA-së

Presidenti rus Vladimir Putin tha në intervistën me Tucker Carlson se ai kishte një marrëdhënie shumë të mirë personale me ish-presidentin e SHBA Donald Trump si me ish-liderin tjetër amerikan, George W. Bush.

"Kam pasur një marrëdhënie shumë të mirë me Bushin", tha Putin. Megjithatë, ai vuri në dukje se Bush "ka bërë shumë gabime në lidhje me Rusinë."

"Por në përgjithësi, në një nivel personal njerëzor, kam pasur një marrëdhënie shumë të mirë dhe me Trump. Ai nuk ishte më keq se çdo politikan tjetër amerikan, rus apo evropian. Ju siguroj se ai e kuptonte atë që po bënte si të tjerët", tha Putin.

## Mbi politikat e SHBA

Politika e Uashingtonit nuk varet nga kush është presidenti i vendit. "Nuk ka të bëjë me personalitetin e liderit. Ka të bëjë me mentalitetin e elitave." Sot, Shtetet e Bashkuara po përpiqen pa sukses të përshtaten me botën në ndryshim duke përdorur forcën, por "mjetet që përdor SHBA nuk funksionojnë". Bota do të "ndryshojë pavarësisht se si do të përfundojnë zhvillimet në Ukrainë". Pozicioni i SHBA-së në botë gjithashtu do të ndryshojë dhe "pyetja e vetme është se si do të ndodhë kjo, me dhimbje dhe shpejt ose butësisht dhe gradualisht".

# Vdes në burg Alexej Navalny, lideri opozitar rus dhe kundërshtari më i madh i Putinit



Lideri opozitar rus Alexej Navalny, një prej kritikëve më të mëdhenj të Vladimir Putinit, Kremlinit dhe politikës së qeverisë aktuale ruse ka vdekur në burg. Lajmin e kanë konfirmuar autoritetet e burgut, ku ai po vuante dënimin shumëvjeçar, me të cilin e kanë denuar autoritetet juridike ruse. Lajmin ndërkohë e kanë konfirmuar edhe shumë media ruse.

Shërbimi burgjeve ruse tha se udhëheqësi i burgosur i opozitës ruse Alexei Navalny, vdiq të premten në rajonin Yamalo-Nenets.

Në një deklaratë të publikuar në faqen e tij të internetit, Shërbimi Federal i Qarkut Autonom të Yamalo-Nenets tha se zoti Navalny "u ndje keq" gjatë një shëtitje të premten, "humbi vetëdijen" dhe shumë shpejt vdiq.

Në njoftim thuhet se personeli mjekësor nuk arriti të ndihmojë zotin Navalny, ndërsa po punohet për të mësuar shkakun e vdekjes.

Zoti Navalny ishte zhvendosur në muajin dhjetor në një burg në një rajon të Arktikut në pjesën veriore të Rusisë.

Ai u arrestua në janar të vitit 2021 pasi u kthye në Moskë nga Gjermania ku po kurohej pas helmimit me agjent nervor, për të cilin fajësoi Kremlinin.

Ndërsa po vuante një dënim prej nëntë vitesh heqje lirie, në gusht të vitit të kaluar u dënua me 19 vjet burg nën akuzat për ekstremizëm.

Zoti Navalny është armiku më i ashpër i Presidentit Vladimir Putin, ka ekspozuar korrupsionin zyrtar dhe ka organizuar protesta të mëdha kundër Kremlinit.

Zëdhënësi i Kremlinit Dmitry Peskov tha se Presidenti rus Putin është njoftuar për vdekjen e zotit Navalny dhe se shërbimet e burgjeve do të hetojnë për vdekjen e tij në përputhje me procedurat standarde.

Zëdhënësja e zotit Navalny Kira Yarmysh njoftoi përmes një postimi në platformën X se ekipi i tij nuk kishte konfirmim për vdekjen e tij dhe se avokati i zotit Navalny ishte rrugës për në qytetin ku ai po mbahej.

Zoti Navalny u burgos në janar të vitit 2021, kur u kthye në Moskë pas trajtimit në Gjermani nga helmimi me një agjent nervor, për të cilin ai fajësoi Kremlinin. Para arrestimit të tij, ai kishte zhvilluar fushatë kundër korrupsionit zyrtar dhe organizuar protesta kundër Kremlinit, si dhe kishte vënë kandidaturën për president.

Ai është dënuar tre herë me burg, të cilat i ka hedhur poshtë si të motivuara politikisht.

Pak orë para vdekjes, zoti Navalny ishte paraqitur në gjykatë, ku shihet duke u ngritur në këmbë, duke qeshur dhe bërë shaka. Këto janë pamjet e tij të fundit, të xhiruara një ditë më herët, gjatë një video lidhje në gjykatën e qytetit Kovrov, nga burgu i sigurisë së lartë në Kharp, ku po vuante dënimin.

Në Rusinë e zotit Putin, kundërshtarët politikë janë përndjekur vazhdimisht nga qeveria, disa janë detyruar të iknin jashtë vendit, pasi janë arrestuar, për të tjerë ka dyshime se janë helmuar, po ashtu ata shpesh janë dobësuar për shkak të përçarjeve brenda tyre, Por zoti Navalny u bë një zë gjithnjë e më i fuqishëm, përmes kurajës, guximit dhe shfrytëzimit me mjeshtëri të fuqisë së rrjeteve sociale në kushtet kur shtypi i pavarur në Rusi është eliminuar nga Kremlini.

Vdekja e tij ngjalli reagime të

menjëhershme.
Nën Presidentja amerikane Kamala Harris, nga Konferenca e Sigurisë në Mynih, tha se Shtetet e Bashkuara po punojnë për të konfirmuar vdekjen e zotit Navanly dhe shtoi se vdekja e tij është edhe një shembull i brutalitetit të Presidentit rus Vladimir Putin.
Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken bëri përgjegjës zotin Putin për vdekjen e kundërshtarit të tij politik.
"Për më shumë se një dekadë, qeveria ruse, Putini, ka përndjekur, helmuar dhe burgosur Alexei Navalnyn… Nëse këto raporte janë të sakta, ngushëllojmë bashkëshorten dhe familjen e tij. Vdekja e tij në një burg rus dhe fiksimi dhe frika e Putinit nga një njeri vetëm, nënvizon dobësinë dhe kalbjen e sistemit të ndërtuar nga Putini. Rusia është përgjegjëse për këtë dhe do të flasim edhe me shumë shtete tjera për Alexei Navalnyn, sidomos nëse këto informacione dalin të sakta," deklaroi zoti Blinken.
Sekretari i përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg tha se Rusia duhet t'i përgjigjet pyetjeve serioze rreth vdekjes së zotit Navalny. "Jam thellësisht i mërzitur dhe i shqetësuar me lajmet që vijnë nga Rusia se Alexei Navalny ka vdekur. Duhet të zbardhen të gjitha faktet. Rusia duhet t'iu përgjigjet pyetjeve serioze. Alexei Navalny ishte një zë i fuqishëm për liri, për demokraci për shumë vite. NATO dhe aleatët e NATO-s kanë bërë thirrje për lirimin e tij për një kohë të gjatë. Sot, ngushëlloj familjen dhe të dashurit e tij. Dhe vazhdojmë të jemi të angazhuar për të përkrahur të gjithë ata që besojnë në demokraci dhe liri siç besonte për shumë vite Alexei Navalny," deklaroi ai.
Edhe nga Tirana zyrtare pati reagime.
Ministri për Europën dhe Punët e Jashtme, Igli Hasani u shpreh sot thellësisht i trishtuar nga lajmi i vdekjes së Alexei Navalny në një burg rus.
Në një reagim në rrjetet sociale, Hasani tha se Navalny jetoi dhe vdiq pa bërë kompromise kur vinte puna për vlerat e demokracisë dhe të drejtave të njeriut, duke u bërë një simbol dhe frymëzim për shumë njerëz.
"Vdekja e tij është një kujtesë e trishtë se sa larg këtyre vlerave është sot Rusia", shkruan kryediplomati shqiptar.



Navalny u dënua me 19 vjet burg në gusht, pasi u shpall fajtor për krijimin e një komuniteti ekstremist, financimin e aktivistëve ekstremistë dhe krime të tjera të ndryshme. Ai po vuante tashmë dënimet me 11 vjet e gjysmë në një strukturë të sigurisë maksimale për mashtrim dhe akuza të tjera që ai mohon.
Katër muaj më vonë, avokatët e tij thanë se kishin humbur kontaktet me Navalny, i cili besohej se ishte i burgosur në një koloni penale rreth 150 milje në lindje të Moskës.
Ai nuk u paraqit në disa seanca të planifikuara gjyqësore në dhjetor. Ekipi i tij ligjor tha më 22 dhjetor se ai ishte zhdukur për 17 ditë.
Pas paraqitjes së 680 kërkesave për të gjetur Navalny, ekipi i tij njoftoi më 25 dhjetor se ata e kishin "gjetur" atë më shumë se një mijë milje larg në koloninë penale IK-3 në Kharp, e njohur si "Ujku Polar".
"Kushtet atje janë të ashpra, me një regjim të veçantë në zonën e permafrostit. Është shumë e vështirë për të arritur atje dhe nuk ka sisteme të dërgesës së letrave, "tha Ivan Zhdanov, drejtor i fondacionit kundër korrupsionit të Navalny.
Navalny i bashkohet një liste të gjatë të disidentëve rusë që vdiqën pasi sfiduan legjitimitetin e Putinit. Shumë venë në dyshim pse ai vazhdoi fushatën e tij pavarësisht nga rreziqet e qarta për sigurinë e tij.
"Unë nuk kam frikë dhe nuk do të heq dorë nga ajo që do të bëj," tha Navalny për CNN në 2018. "Unë nuk do të heq dorë nga vendi im. Unë nuk do të heq dorë nga të drejtat e mia civile. Nuk do të heq dorë nga bashkimi i atyre rreth meje që besojnë në të njëjtat ideale si unë. Dhe ka shumë njerëz të tillë në Rusi."

**Dear readers and followers of Argumentum.al**

On the third anniversary of the founding of the online media Argumentum.al, now it comes in the version of a monthly magazine which you can browse online from April 2022.

This monthly publication offers a clear combination of news on Albania, the Western Balkans and the world, as well as opinions and analyses of events taking place during the month.

Thanking each of you for your attention and trust in our media, we promise that we will continue to publish objective analysis on key developments in the country, region, Europe and the world.

Argumentum.al strives to be an authoritative source of journalism with analyses and comments on international relations, world politics and a wide range of issues of global importance by publishing exclusive materials. This is done thanks to the contribution of some of the well-known names of Albanian politics and journalism and other local and foreign collaborators. At the same time, Argumentum.al is open for comments and opinions by its readers.

Read on domestic and international issues in the magazine Argumentum.al free of charge in Albanian and English!

***"Argumentum", an intellectual process...***



"English Edition"

# US secretary Blinken in Tirana, appreciates PM Edi Rama and alliance with Albania




U.S. Secretary of State Antony Blinken traveled to Albania for the first time on Thursday as part of efforts to "reaffirm the strength of the United States' relations" with the Balkan nation, according to State Department officials.

Remarking upon the "extraordinary partnership" between the countries, Blinken commended Albania for its stance protecting Ukrainian sovereignty and its role as U.N. Security Council Chair in 2023, calling Tirana a "key partner for stability in the Western Balkans and a firm ally in supporting Ukraine's sovereignty and territorial integrity."

Following a warm welcome featuring large posters of Blinken's face on buildings, the top U.S. diplomat met with key officials including Albanian Prime Minister Edi Rama and President Bajram Begaj.

Begaj praised Blinken's leadership, expressing gratitude for the administration's work for "Albania, for Kosovo and in the region."

Blinken reciprocated the sentiments, calling the relationship critical to prevailing geopolitical challenges.

Efforts to deepen U.S.-Albanian ties come as Tirana seeks EU integration and an ongoing role within NATO, which the U.S. supports.

Later this month, Albania is set to host an international summit on the situation in Ukraine, which Ukrainian President Volodymyr Zelenskyy is expected to attend.

Blinken also met with young Albanians during a youth forum at the Tirana Pyramid, a onetime monument to former Albanian leader Enver Hoxha, who led the country into isolation, but has since been converted into a hub for education and innovation.

During the event, "Celebrating the Future of the U.S.-Albania Relationship," Blinken thanked the organizers for their stewardship of bilateral ties and praised Rama's leadership, calling him "both an extraordinary leader and an extraordinary partner."

# Ukraine-Southeast Europe Summit Declaration




We, President Vjosa Osmani, President Maia Sandu, President Jakov Milatović, President Stevo Pendarovski, President Alexandar Vučić, President Volodymyr Zelenskyy, Prime Minister Edi Rama, Chairwoman of the Council of Ministers Borjana Krišto, Prime Minister Nikolay Denkov, Prime Minister Andrej Plenković, Prime Minister Ion-Marcel Ciolacu, gathered in Tirana on February 28, 2024, and issued the following declaration:

**1.** Russia's unprovoked military aggression against Ukraine remains the greatest threat to the European security and international peace. This act of aggression is unacceptable; it is a flagrant violation of international law, including the UN Charter, and a crime against the Ukrainian people.

**2.** We reiterated our unwavering support for the independence, sovereignty, and territorial integrity of Ukraine within its internationally recognized borders as of 1991 and remain committed to providing Ukraine with necessary support to prevail against the Russian war of aggression for as long as it takes in order to achieve a comprehensive, just and lasting peace in accordance with the UN Charter and on the basis of the Ukrainian Peace Formula.

**3.** We call on the whole international community to strongly increase support to Ukraine in its ongoing struggle for freedom, independence and territorial integrity.

**4.** We strongly condemn the intentions of the Russian Federation to hold presidential elections in the temporarily occupied territories of Ukraine, which represents a blatant violation of international law. We emphasize the illegal nature of the upcoming elections in the Autonomous Republic of Crimea and the city of Sevastopol and in Russia-occupied territories of the Donetsk, Luhansk, Zaporizhzhya and Kherson regions of Ukraine.

**5.** During today's discussions in Tirana, we reaffirmed our solidarity with Ukraine and its people in their heroic defense of their freedom and our shared values and expressed our readiness to participate in the implementation of the Peace Formula of President of Ukraine Volodymyr Zelenskyy, which is in line with the Purposes and Principles of the UN Charter, and to take part in the inaugural Peace Summit, ensuring the widest possible international participation in this process.

**6.** We are convinced that Russia's full-scale war of aggression against Ukraine has demonstrated the critical need and crucial importance of a united and strong Europe capable of facing global challenges for the peace and prosperity of our peoples. We emphasized that we are united by common European values and a vision of their further development within a united Europe.




**7.** We reaffirmed our determination to intensify joint efforts to ensure further progress and mutual support towards the membership of the Western Balkan region, Ukraine, the Republic of Moldova, and Georgia in the European Union.

**8.** We fully support Ukraine's right to choose its own security arrangements. NATO Allies and aspiring countries commend the steps taken towards its future membership in NATO and support Ukraine to become member of the Alliance as soon as security conditions allow.

**9.** We underlined our firm commitment to bring to justice those individuals responsible for the crime of aggression, crimes against humanity and other atrocity crimes under international law committed in connection with Russia's war of aggression against Ukraine, through appropriate, fair and independent investigations and prosecution at the national or international level, including through the work of the Office of the Prosecutor General of Ukraine and the International Criminal Court to ensure that allegations of war crimes and other international crimes are fully and fairly investigated by independent, effective and robust legal mechanisms.

**10.** We agreed to cooperate and focus our efforts on the return of unlawfully and illegally deported and forcibly relocated Ukrainian children.

**11.** We pledge to enhance our cooperative efforts to fight misinformation, including fake narratives about the war, and to remain committed in combating hybrid warfare and cybersecurity challenges, contributing to the stability and security of the international community.

**12.** Today in Tirana, we reaffirmed our solidarity and support for Ukraine, expressed our commitment to participate in the post-war recovery and reconstruction of Ukraine in order to enable the Ukrainian people to rebuild their country, engaging all relevant partners, including private companies and international financial institutions, with the aim of securing the financial support, investments and knowledge needed to ensure a prosperous future for Ukraine. We underline the importance of demining in the broader context of Ukraine's recovery, as the crucial initial step toward the safe return of people and resumption of economic and agricultural activity.

We, the friends of Ukraine, confirm our firm belief that only by uniting we will be able to restore just peace, stability, and prosperity on the European continent.

# Kurti and Vučić face off at the UN over dinar




The Prime Minister of Kosovo Albin Kurti is in the USA where he will participate in the extraordinary meeting of the United Nations Security Council, where the situation in Kosovo will be discussed.

This session was called at the request of Serbia, after Kosovo's decision to ban the Serbian dinar and due to the closure of several parallel Serbian municipalities.

In this meeting, Serbia will be represented by President Aleksandar Vučić, while Kosovo is expected to be represented by Prime Minister Albin Kurti.

Since February 1, the regulation of the Central Bank of Kosovo for cash operations has entered into force in Kosovo.

> Since February 1, the regulation of the Central Bank of Kosovo for cash operations has entered into force in Kosovo. This regulation stipulates that the only currency for payments is the euro, prohibiting the use of the Serbian dinar.

This regulation stipulates that the only currency for payments is the euro, prohibiting the use of the Serbian dinar.

The national currency of Serbia has been used by Serbs in Kosovo since the end of the war in 1999.

Likewise, Serbia pays Kosovo's Serbian citizens, through a parallel system, salaries, pensions, social assistance and other benefits.

Serb List- the main party of Serbs in Kosovo – has said that nearly 100,000 Serbs will be affected by the CBK's decision.

The Serbian President, Aleksandar Vučić, has stated that his country has 31,831 employees in Kosovo, 29,115 pensioners – of which 4,700 receive their pensions – and 31,586 social assistance users.

The Prime Minister of Kosovo, Albin Kurti, has said that the implementation of the regulation is being done through a transition period, insisting that the CBK's decision does not mean the banning of the Serbian dinar.

# Zelenski in Tirana! Summit for the sake of summit! Not like Nastradin's music! If you want peace, prepare for war! EBRD and Basso strips off our veil"!

REALPOLITIK FLASH NO. 65 | 19 – 29 FEBRUARY 2024 | EXCLUSIVELY FOR ARGUMENTUM

**On 5 major diplomatic events briefly with only 1.000 words by by Dr. Jorgji KOTE, Grand Master**



DR. JORGJI KOTE *GRAND MASTER*

**1.**

Not like Nastradin's music! On 20 February, Prime Minister Rama was a guest in Ankara where he was hosted with pump and glamour by President Erdogan and signed a few agreements. An extremely important visit after a certain cool off, due to our reluctancy to hand over gylenists. Foreign Minister Fidan Hakani laid down the track with his visit in Triana few weeks ago. The message was that there is no more time to wait! It's a very good thing to have a great ally as Turkey in such turbulant geopolitical times. But caution is needed, for it may occur as they say as in the case of Nastradin Hodja, whose "musical tune is heard better later"; particularly with the destiny of remaining gylenists and the State Committee of Moslems, where the first signs of crisis are seen. Let us hope this visit will be beneficial for both peoples.



## 2.

If you want peace, prepare for war! On 24 February was commemorated the Second Anniversary of the Russian aggression against Ukraine. There were many analyses, comments, events and summits on this occasion, as the Summit with 20 western leaders in Paris hosted by President M`acron on 26 February, G-20 and G-7 with their resolution to support Ukraine as long as necessary. In all these




cases, the denominator was what the German Chancellor stated during the Munich Conference on 19 February that " without security all is nothing!". Therefore, " the war diplomacy" is on the top agenda now. This was also the intention by President Macron statement that the troops intervention in Ukraine is not excluded".

German Chancellor Olaf Scholz speaks during the 60th Munich Security Conference (MSC). Photo: Sven Hoppe/dpa

Even though it was objected instantly both by NATO and the USA, since if that occurs, it would mean an open war with Russia. When Putin is threatening with victory at all costs and total destruction of Ukraine, there is no more room for peace conferences and proposals. So, Europe and the USA have already started but they should "show their teeth an muscles" to Putin and their determination to do the utmost for their victory. Only this victory may pave the way to classic diplomacy, to make both sides sit around the table as victorious, imposing the winners' will. As many war historians and strategists have stated during these days, if Europe and Germany wll be attacked in the coming years by Russia, there is no guarantee for victory, since they need 10 – 15 years to make things ready for an all- out war; starting with recruitment, construction of bunkers, revitalizing arms factories and so on.

## 3.

EBRD and Mme Basso stripped off our veil in the 10th Summit of the European Bank for Reconstrucrtion and Development (EBRD) on 26 February in London with the 6 Western Balkans leaders. The EBRD role in our region with over 18 billion of Euro invesments is well-known. The annual meeting has become a routine now where the leaders make political and public marketing. The highlights of this meeting were Rama's statement on major changes in Albania and the understatement by the Serbian PM Bernabic that Kosovo is allegedly part of Serbia, which was defied by Kosovo's PM Kurti. However, this time, it was the EBRD President, Mrs. Basso that stamped this meeting with the bitter declaration that Albania and other WB states will need at least 7 decades or even more to fill the gap with the EU member states.

This occurred when we claim

that we deserve to be EU members right now but " Brussels is not sending the bride". This overshadowed all other statements and achievements. In brif, Madame Basso showed that while we are very good outside, we are on a bad shape inside, i.e. geopolitics alone is not enough, it needs good governaence as well!!




## 4.

Zelenski in Tirana in the first Summit of Southeast Europe – Ukraine held on 28 February in Tirana! Significant for the country's image and a symbolic message that WB stands with Ukraine. The comments, guessings and projections on this event are explained with the way how diplomacy works; they are implied and left to time to judge on them; together with the joint statements they set the proper legal and diplomatic ground for each country for more concrete positions in support of Ukraine, including military aspects. Well, Albania did its job well as a NATO member. However, one can say that if Zelenski was the high guest, the true summit winners were Rama, as the host and Vuçiç; the latter avoided with Rama's assistance three delicate and compromising phrases for Belgrade's role vis à vis Russia; moreover, they deleted even the term " state", since it could imply the recognition of Kosovo; and they tell us that Belgrade is recognizing Kosovo " de facto" nonsense!

## 5.

Samit for the sake of summit was the one of 29 February in Tirana. We say this because actually, the EU Economic Growth Plan for Western Balkans 2023 – 2027 was announced in Tirana Summit on 16 October 2023, then in November and December in Brussels and in Skopje on 22 January even at a higher format. This is natural given the significance and difficulties for its implementation in the "swamps" of WB corruption. The leaders of our countries are used to receive all funding ready made, without serious projects, therefore their benefits are lacking to a great extent.




Thus, although the EU collected 1,1 bilion Euro for the earthquake of 26 November 2019 very little was used, due to failure to comply with several necessary EU procedures. But the sinn is ours and not of EU, whose rules should be observed if we want to benefit from the 6 billion Euro package. They will be allocated only upon measurable progress in the implementation of reforms, the rule of law and other major aspects.

# OSCE leaders demand immediate end to Russia's war against Ukraine

Today, as we mark the second year of Russia's full scale war against Ukraine, the OSCE Troika – Chair-in-Office of the OSCE and Minister of Foreign and European Affairs and Trade of Malta Ian Borg, Minister of Foreign Affairs of North Macedonia Bujar Osmani and Minister for Foreign Affairs of Finland Elina Valtonen – and OSCE Secretary General Helga Maria Schmid call on Russia to immediately stop its war against Ukraine and to respect the country's sovereignty and territorial integrity within its internationally recognized borders.




"Throughout Malta's Chairpersonship of the OSCE, Ukraine will remain a priority" said Chair-in-Office Minister Ian Borg, adding that "Russia's illegal war of aggression against Ukraine has not only undermined peace and stability across the OSCE region, but also set a concerning precedent for global security and the international rules-based order." Minister Borg reiterated his pledge to maintain the OSCE's support to Ukraine in addressing and mitigating the fallout of the aggression. Highlighting this commitment, Minister Borg's recent visit to Kyiv conveyed a resolute message of enduring determination and willingness to further deepen cooperation between Ukraine and the OSCE.

Minister of Foreign Affairs of North Macedonia Bujar Osmani added "This war is not waged only on the battlefield. Ukrainians are its immediate victims but the consequences go beyond; they are widespread and complex. Today, the very essence of human dignity and freedom has been challenged. Here, at the OSCE, we must continue exposing Russia and condemning its illegal and unjustified aggression, to request for its immediate cessation and to hold those responsible to account. We have a duty to join and effectively support the struggle of all those defending freedom, democracy and justice."

In her remarks, Minister for Foreign Affairs of Finland Elina Valtonen reiterated Finland's respect for and admiration of the courage, resistance and perseverance of Ukraine and its people, adding that Ukraine will remain at the centre of the work in the OSCE also during the Finnish Chairpersonship in 2025. "Finland is dedicated to ensuring full accountability for Russia's war of aggression against Ukraine," stated Minister Valtonen, recalling that three Moscow Mechanisms have so far been invoked to investigate the impact of the war. Minister Valtonen also added that Finland will work in the International Coalition, convened by Ukraine and Canada, for the return of Ukrainian children who have been unlawfully deported or forcefully transferred by Russia in violation of their rights, and of international law.

Secretary General Schmid said "these have been two years of death and tragedy which have caused unbearable suffering to so many innocent civilians. Among them are three OSCE colleagues who have been detained in Donetsk and Luhansk for almost 700 days now. I reiterate our call for their immediate return to their families and will continue to use every channel and every opportunity to secure their release".

# Putin says defeat in Ukraine ‘impossible’ in interview with US journalist Tucker Carlson

***President Vladimir Putin said in an interview released Thursday with controversial right-wing US journalist Tucker Carlson that the West should understand it is “impossible” to defeat Russia in Ukraine.***



In a two-hour interview with the former Fox News host – coming just ahead of the two-year anniversary of Russia’s invasion of Ukraine – Putin also said a deal “can be reached” on imprisoned Wall Street Journal reporter Evan Gershkovich.

“Certain terms being discussed via special services channels,” he said, while insisting that the reporter is a spy – something the Journal and US government vehemently deny.

It was the first one-on-one interview of Putin by someone from the Western media since 2019.

However Carlson, who is close to White House candidate and former president Donald Trump, asked few tough questions and largely listened while the Kremlin leader lectured him on his views of Russian history, portraying the country as a victim of Western betrayals.

Putin defended his decision to invade Ukraine in February 2022. And he said the West now realises that Russia will not be defeated, despite US, European and NATO help to Ukraine.

“Up until now, there has been the uproar and screaming about inflicting a strategic defeat to Russia on the battlefield. But now they are apparently coming to realise that it is difficult to achieve, if possible, at all. In my opinion, it is impossible by definition,” he said.

He also aimed a message at the US Congress, where Trump-dominated Republicans are increasingly reluctant to keep backing Ukraine with weapons and other military aid.

“I will tell you what we are saying on this matter and what we are conveying to the US leadership. If you really want to stop fighting, you need to stop supplying weapons,” he said.

When asked if Moscow would consider invading other countries in the region – NATO members Poland and Latvia – or generally across the European continent, Putin said that was “out of the question.”

“We have no interest in Poland, Latvia or anywhere else. Why would we do that? We simply don’t have any interest. It’s just threat mongering,” Putin said.

A war with Poland, he said, would happen “only in one case: if Poland attacks Russia.”

Asked about a possible change in leadership after the US election, where Biden is expected to face off against Trump in a rematch of their 2020 contest, Putin indicated he would see little change.

“You just asked me if another leader comes and changes something? It is not about the leader. It is not about the personality of a particular person.”

Carlson rarely pushed back in his interview – recorded Tuesday and posted on Carlson’s own website – and did not challenge Putin over his relationship with Trump.

While president and since being defeated by Biden, Trump has repeatedly praised Putin and failed to condemn the invasion of Ukraine – saying that if he was reelected he would be able to solve the war in “24 hours,” though not saying how.

By contrast, Biden has branded Putin a “war criminal” and has made backing for Ukraine’s elected, pro-Western government one of the key priorities of his presidency.

ARGUMENTUM

news opinion analysis

Adresa:  Njësia bashkiake nr. 5, Rruga “Abdyl Frasheri”, Ndërtesa 8, Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 (0) 68 82 01 720

Email:  redaksia.argumentum@gmail.com,

info@argumentum.al

NUIS/NIPT: L91415033Q

Twiter : Argumentum_al

Facebook: argumentum.al

Instagram: argumentumnews

© Argumentum. All rights reserved